



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:043382
Datë: 21.02.2024
Numri i dokumentit: 05350774

AA.nr.512/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS-Departamenti për çështje administrative, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Ramiz Kuqi, kryetar, Hajriz Hoti dhe Delushe Halimi, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Besarta Sopaj, procesmbajtës, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit M.M nga Prizreni, kundër të paditurës Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale-Departamenti i Pensioneve të Republikës së Kosovës, në Prishtinë, me bazë juridike anulim i vendimit, duke vendosur sipas ankesës të paditësit, kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.620/2020 të datës 19.05.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 14.02.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa e paditësit M.M nga Prizreni.
- II. Anulohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative A.nr.620/2020 i datës 19.05.2023.
- III. Anulohet vendimi i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale - Departamenti i Pensioneve në Prishtinë me numër të dosjes 259735 i datës 20.12.2019 dhe lënda i kthehet të paditurës në rishqyrtim dhe rivendosje.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, duke vendosur sipas padisë së paditësit M.M nga Prizreni, kundër vendimit të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale - Departamenti i Pensioneve në Prishtinë të datës 20.12.2019, me aktgjykimin e ankimuar e ka refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ka ushtruar ankesë paditësi, për shkak të: shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës administrative, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe zbatimit të gabuar të së drejtës material, ashtu siç rrjedh nga të

thënat në ankesë. Në ankesë në mes tjerash thekson se me vendimin e gjykatës themelore asnjë nga provat e parashtruara nga unë nuk është marrë për bazë në veçanti prova e vendimit të Gjykatës së Prizrenit të vitit 1997 e cila na ktheu të 7 puntorët e Printeks-it në punë si të pafajshëm, por organi i dhunshëm refuzoi ta zbatoj vendimin e Gjykatës së Prizrenit. Unë kërkova nga Gjykata Themelore në Prishtinë të verifikojnë se a u është pranuar stazhi i punës kontributpaguesve të tjerë të cilët Gjykatat Komunale të Kosovës i kishin kthyer në punë kurse ata nuk e kishin plotësuar kuotën prej 15 vite kontributpaguesi, ngase ka shumë raste kur Ministria e Punës dhe Mirëqenjes Sociale i ka pranuar stazhin e punës kur ka pasur vendime të Gjykatës Komunale edhe atëherë kur pala nuk i kishte 15 vite kontributdhënje kurse në rastin tim Ministria e Punës fare nuk i përgjigjet në pyetjen time e cila është pjesë e ankesës por as Gjykata Themelore në Prishtinë nuk e obligon MPMS, Departamentin e Pensioneve të konfirmoj se a ka persona në Kosovë të cilët e kanë gëzuar pensionin e plotë me vendim të gjykatës komunale të Kosovës para vitit 1999 dhe që nuk i ka pas 15 vite kontributdhënje dhe në qoftëse përgjigjja është po, gjithë ata që para vitit 1999 kanë prezantuar dokumente të gjykatës komunale dhe që nuk kanë pasur 15 vite kontributdhënje, atyre eksperiencia punës prej 15 vitesh u është pranuar kurse mua jo... Me propozim që ankesa të aprovohet si plotesisht e bazuar në ligj, dhe këtë here gjykata do të shqyrtoj faktet e parashtruara të ankesës sime dhe me theks të posaqëm në faktin e vendimit të Gjykatës së Prizrenit do të merrte vendim të drejt në favorin tim.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, vendimin e kontestuar të paditurës, pretendimet ankimore në ankesë, dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 49 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, gjeti se:

Ankesa është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi ka ushtruar padi kundër të paditurës me bazë juridike për anulimin e vendimit me nr. 259735 i datës 20.12.2019 të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale - Departamenti i Pensioneve në Prishtinë, me të cilin është refuzuar ankesa e M.M nga Prizreni me nr. të ID-së 1002756575 dhe numër të dosjes 259735 për njohjen e të drejtës në pension kontributpagues të moshës.

Paditësi i pa kënaqur me vendimin e lartcekur të paditurës Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale - Departamenti i Pensioneve në Prishtinë, ka ushtruar padi për konflikt administrativ me datën 09.04.2020, duke kontestuar ligjshmërinë e tij, me propozim që i njëjti të anulohet si i kundërligjshëm.

Gjykata e shkallës së parë pasi vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të goditur me padi në përputhje me nenin 44 të LKA-së dhe provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor dhe gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar. Gjykata e shkallës së parë ka shqyrtuar ligjshmërinë e aktit administrativ brenda kufijve të kërkesëpadiës, në vështrim të nenit 44 të LKA-së. Gjykata e ka pranuar si të bazuar konstatimet dhe qëndrimet ligjore të dhëna në arsyetimin e vendimit kontestues të paditurës, për arsye se, paditësi as ne procedurën e ankesave dhe as ne këtë konflikt administrativ nuk ka mundur të dëshmojë një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar nga e paditura. Gjykata e shkallës së parë ka shqyrtuar pretendimet

e paditësit si dhe bazën ligjore të kërkesëpadisë dhe pas administrimit të provave ka konstatuar se paditësi nuk ka bashkangjitur prova të mjaftueshme se paditësi ka 15 vite stazh kontributiv, dhe se në bazë të provave materiale të bashkangjitura figurojnë të dhëna për 11 vite e 9 muaj e 19 ditë të stazhit kontributiv siç është cekur edhe në vendimin e të paditurës. Për të vlerësuar bazën ligjore të kërkesëpadisë, gjykata e shkallës së parë iu referua nenit 8 të Ligjit nr.04/L-131. Në bazë të Udhëzimit Administrativ (MPMS) Nr. 09/2015 për Kategorizimin e Shfrytëzuesve të Pensionit Kontribut pagues sipas Strukturës Kualifikuese dhe Kohëzgjatjes së Pagesës së Kontributeve-Stazhit Pensional, i cili UA në nenin 5 parag.2,3,4 ka përcaktuar kualifikimin e shfrytëzuesve të pensionit kontributpagues: *Shfrytëzuesi i pensionit kontributpagues me përgatitje shkollore të mesme, konsiderohet pensionisti, përkatësisht i siguruari i cili ka të kryer shkollën e mesme. Shfrytëzuesi i pensionit kontributpagues me përgatitje shkollore të lartë, konsiderohet pensionisti, përkatësisht i siguruari i cili e ka të kryer shkollimin e lartë. Shfrytëzuesi i pensionit kontributpagues me përgatitje shkollore superiore, konsiderohet pensionisti, përkatësisht i siguruari i cili ka të kryer fakultetin apo studimet pasuniversitare. Të gjitha dëshmitë për kualifikim, të përcaktuara nga paragrafët 2, 3 dhe 4 të këtij neni, duhet të jenë para vitit 01.01.1991.* Nga dispozitat ligjore të lartcekura dhe provave të administruara kuptohet se paditësi nuk i plotëson kriteret ligjore që ti njihet pensioni kontributpagues për faktin se në baze të shkresave të lëndës nuk ka prova të mjaftueshme se paditësi i ka 15 vite stazh kontributiv para vitit 01.01.1991, dhe se në bazë të provave materiale të bashkangjitura figurojnë të dhëna për 11 vite e 9 muaj e 19 ditë të stazhit kontributiv, ndërsa dispozitat ligjore të lartcekura parashohin se të gjitha dëshmitë për kualifikim, të përcaktuara nga paragrafët 2, 3 dhe 4 të këtij neni, duhet të jenë para vitit 01.01.1991. Në procedurën e konfliktit administrativ gjyqësor, gjykata e shkallës së parë pasi ka shqyrtuar provat e administruara dhe dispozitat ligjore në fuqi mbi bazën e të cili është bazuar vendimi kontestues ka konstatuar se e paditura ka vepruar drejt kur me vendimin kontestues ka refuzuar ankesën e paditësit për arsye se, paditësi nuk i plotëson kriteret ligjore që ti njihet e drejta e pensionit kontributpagues. Gjykata e shkallës së parë nga provat e administruara ka vërtetuar se e paditura e ka vërtetuar gjendjen faktike në harmoni të plotë me dispozitat ligjorë në fuqi. Nga kjo gjendje faktike të mbështetur në provat e siguruara gjatë procedurës administrative, Gjykata e shkallës së parë pranon konstatimet e cekura në arsyetimin e vendimit kontestues se paditësi prova të mjaftueshme se paditësi ka 15 vite stazh kontributiv, dhe se në bazë të provave materiale të bashkangjitura figurojnë të dhëna për 11 vite e 9 muaj e 19 ditë të stazhit kontributiv, ashtu siç parashihet me UA 09/2015. Në këtë kuptim, gjykata pajtohet me qëndrimin juridik dhe faktike të paditurës pasi që në kontekst të argumenteve ligjore dhe provave të paraqitura në këtë konflikt administrative paditësi nuk ka mundur me argumentuar një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar nga e paditura, njashtu në arsyetimin e vendimit kontestues është bërë vlerësim i fakteve në harmoni me dispozitat ligjore.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes dhe pas ekzaminimit të aktgjykimit, e duke i pasur parasysh edhe pretendimet ankimore, gjen se aktgjykimi i kontestuar është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.2 pika n), dhe nga neni 183 e 184 i LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, pasi që i njëjti është juridikisht i paqartë dhe kundërthënës me vetveten dhe me arsyetimin e tij, dhe si i tillë është jo ligjore dhe jo i plotë në vërtetimin e gjendjes faktike, për çka në mënyrë të bazuar theksohet në ankesë.

Aktgjykimi i ankimuar është juridikisht i paqartë, sepse në të nuk janë shqyrtuar dhe administruar provat sipas pretendimeve të palëve në procedurë dhe sipas objektit të shqyrtimit – vlerësimin të ligjshmërisë së aktit përfundimtar të MPMS-DP-së, si në vështrim të nenit 9 dhe 44 të LKA-së, siç pretendon paditësi në ankesë.

Andaj, vlerësimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, kjo gjykatë nuk mund ta merr si të rregullt dhe të ligjshëm për arsye se aktgjykimi i ankimuar është përfshirë me shkelje të dispozitave të lartcekura. Gjykata e Apelit vlerëson se qëndrimi i gjykatës së shkallës së parë, nuk mund të pranohet si i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që pas vendimit KO190/19 të datës 30.12.2022 të Gjykatës Kushtetuese, ka pasuar Ligji Nr.08/L-248 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, i cili e shfuqizon paragrafin 2 të nenit 8 të Ligjit për Skemat Pensionale, me arsyetimin “se pa të drejtë iu mohoi mijëra qytetarëve të drejtën e pensionit kontributpagues”. Sepse me ligjin e vjetër parashihej që të drejtën e përfitimit të pensionit kontributpagues ta kenë vetëm ata që dëshmojnë se kanë kontribuar për 15 vjet e më shumë në ish Fondin Pensionale të Kosovës. Ndërsa me ndryshimin e ligjit janë përfshi edhe qytetarët që janë larguar nga puna dhe nuk kanë arritur të mbushin 15 vjet përvojë pune. Andaj Gjykata e Apelit vendosi që ta anuloi aktgjykimin e ankimuar dhe njëherit ta anuloi edhe vendimin e MPMS-DP-së si jo të drejtë dhe jo ligjor.

Mbi këto arsye kolegji i Gjykatës së Apelit, e aprovoi ankesën si të bazuar meqë pretendimet e paditësit ishin pretendime të bazuara në ligj. Ngase duke marr parasysh dispozitat e lartcekura, kjo gjykatë e ka të pamundur të vlerësoj ligjshmërinë e vendimit të paditurës, sepse nuk ju ka përmbajtur nenit 48 të LPPA-së, për shkak se me arsyetimin e dhënë, nuk i ka dhënë përgjigjet dhe sqarimet e nevojshme në raport me ankesën e palës paditëse, nuk i ka përfshirë shpjegimet ligjore dhe faktike, dhe se vendimi i kundërshtuar është juridikisht i paqartë dhe kundërthënës me vetveten dhe me arsyetimin e tij, ashtu që të njëjtin aktgjykim e anuloi dhe njëherit edhe vendimin e të paditurës MPMS-DP-së. Në vazhdim të procedurës organi i paditur pas shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të lëndës për vërtetimin e kritereve për njohjen e të drejtës në Pension kontribut pagues është i obliguar që të vendos ligjërisht lidhur me ankesën e paditësit, duke pasur parasysh Ligjin Nr.08/L-248 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, përkatësisht nenin 8/A me të cilin është paraparë Pensioni parcial kontributpagues i moshës.

Nga të lartë cekurat e në kuptim të nenit 43 par.2 dhe 49 të LKA-së, dhe nenit 195 par. 1 pika e) i zbatueshëm përmes nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
AA.nr.512/2023, me datë 14.12.2024

Kryetari i kolegjit,
Ramiz Kuqi